KOMUNIKATË PËR MEDIA

Llogaritë Qeveritare TM2 2023

01.09.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Llogaritë Qeveritare për tremujorin e dytë (TM2 2023). Ky publikim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe.

Rriten të hyrat e Qeverisë në TM2 2023 krahasuar me TM2 2022

Gjithsej të hyrat e Qeverisë së Përgjithshme në TM2 2023 ishin 654,4 milion Euro, ndërsa të hyrat në TM2 2022 ishin 635,2 milion Euro.

Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatimet në produkte, të cilat paraqesin 75% të totalit të të hyrave, tatimet rrjedhëse në të ardhura 21%, ndërsa pjesa e mbetur është shpërndarë në kategori të tjera të të hyrave.

Shpërdarja e të hyrave të Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA2010



Struktura e të hyrave të Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA2010 (në milion Euro)

ESA2010	Përshkrimi	TM1 2021	TM2 2021	TM3 2021	TM4 2021	TM1 2022	TM2 2022	TM3 2022	TM4 2022	TM1 2023	TM2 2023
D21	Tatimet në produkte	**336,6**	**395,5**	**485,0**	**437,9**	**394,4**	**427,2**	**547,3**	**487,4**	**430,7**	**490,5**
D211	Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)	201,9	237,7	282,5	262,3	250,4	267,2	332,8	305,7	281,6	307,8
D212	Tatimi dhe dogana në importe duke përjashtuar TVSH	125,1	146,7	190,5	164,5	133,1	148,9	201,1	169,4	136,6	170,6
D2121	*Detyrimet e importit*	24,9	29,0	37,1	35,7	27,5	32,6	37,8	38,0	31,7	36,5
D2122	*Taksat për importet pa TVSH dhe detyrimet*	100,2	117,7	153,3	128,9	105,6	116,3	163,3	131,3	105,0	134,1
D214	Tatimi mbi produktet, me përjashtim të TVSH-së dhe tatimet e importit	9,5	11,1	12,1	11,1	10,9	11,0	13,3	12,3	12,5	12,1
D29	Tatimet tjera në prodhim	**13,0**	**4,5**	**12,2**	**10,5**	**20,2**	**12,0**	**15,4**	**11,1**	**12,7**	**10,3**
D4	Të hyrat nga prona	**6,2**	**8,9**	**14,5**	**13,3**	**2,1**	**9,5**	**11,0**	**11,7**	**4,3**	**38,9**
D5	Tatimet rrjedhëse në të ardhura, pasuri, etj.	**73,1**	**94,8**	**82,3**	**80,3**	**96,1**	**112,0**	**94,8**	**96,8**	**112,5**	**140,6**
D7	Transfertat e tjera aktuale	**14,9**	**9,9**	**8,6**	**10,4**	**10,4**	**10,8**	**20,2**	**12,6**	**80,1**	**13,4**
F	Aktivet dhe detyrimet financiare	**58,9**	**122,3**	**42,7**	**44,4**	**12,2**	**37,2**	**-18,9**	**81,9**	**10,3**	**-66,6**
P131	Pagesat për prodhimet jo-tregtare (Shitjet)	**20,9**	**24,2**	**28,6**	**30,3**	**22,2**	**26,5**	**27,7**	**30,6**	**25,1**	**27,3**
Gjithsej		**523,6**	**660,0**	**673,9**	**627,1**	**557,6**	**635,2**	**697,5**	**732,1**	**675,8**	**654,4**

Shpenzimet e Qeverisë më të mëdha në TM2 2023 krahasuar me TM2 2022

Gjithsej shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme në TM2 2023 ishin 645,9 milion Euro, ndërsa shpenzimet në TM2 2022 ishin 581,7 milion Euro.

Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë kompensimi i punëtorëve me 29%, kontributet sociale dhe përfitimet me 24%, konsumi i ndërmjetëm 16%, ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në kategori tjera të shpenzimeve.

Shpërndarja e shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA2010



Struktura e Shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA2010 (në milion Euro)

ESA2010	Përshkrimi	TM1 2021	TM2 2021	TM3 2021	TM4 2021	TM1 2022	TM2 2022	TM3 2022	TM4 2022	TM1 2023	TM2 2023
D1	Kompensimi i punëtorëve	169,8	162,3	154,4	161,5	160,0	160,5	142,7	174,1	176,7	186,1
D3	Subvencionet	46,6	26,6	42,2	105,1	26,3	55,1	140,9	177,5	59,3	64,0
D4	Të ardhurat nga prona, të pagueshme	8,5	6,4	9,2	6,7	9,7	7,2	10,3	7,9	10,9	11,9
D6	Kontributet sociale dhe përfitimet	150,1	138,1	134,7	196,2	145,0	180,9	150,1	187,8	148,3	158,7
D7	Transfertat e tjera aktuale	8,3	9,9	11,5	22,7	8,7	12,3	10,6	16,2	6,5	10,2
D9	Transfertat kapitale	0,3	3,6	2,6	3,2	0,0	33,4	1,2	3,4	0,4	0,7
F	Aktivet dhe detyrimet financiare	22,8	24,2	29,0	56,2	20,0	10,9	10,4	95,1	8,9	10,5
NP	Posedimi i aktiveve jo-prodhuese	2,8	1,6	2,7	14,8	13,9	10,1	11,6	17,2	8,4	9,7
P2	Konsumi i ndërmjetëm	59,8	77,7	71,2	125,2	58,1	80,3	79,6	140,3	64,0	101,4
P5	Formimi i kapitalit bruto	52,0	55,4	69,2	130,8	18,0	31,0	58,6	147,0	28,4	92,6
Gjithsej		**521,0**	**505,9**	**526,9**	**822,6**	**459,7**	**581,7**	**615,9**	**966,5**	**511,8**	**645,9**

Për më shumë informata lidhur me Llogaritë Qeveritare TM2 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/Budget